

“SFIDAT E SIGURISË RAJONALE PAS LUFTËS SË FTOHTË – RASTI I  
KOSOVËS”

TEMA PËR TITULLIN  
MASTER I SHKENCËS POLITIKE – POLITIKË NDËRKOMBËTARE

NGA

LEUTRIM HOTI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI FILOZOFIK  
SHKENCA POLITIKE – POLITIKË NDËRKOMBËTARE  
PRISHTINË

NËNTOR, 2021

# “SFIDAT E SIGURISË RAJONALE PAS LUFTËS SË FTOHTË – RASTI I KOSOVËS”

Mentor: Prof. Dr. Ibrahim Gashi

Kosova dhe rajoni ka më se dy dekada që është dalë nga Lufta e përgjakshme në Jugosllavi. Lufta e përgjakshme ka lënë pasojë të shumta në Ballkanin Perëndimor. Pas 20 vjeteve Kosova dhe rajoni ballafaqohen me kërcënime në aspektin e sigurisë dhe stabilitetit. Kosova nuk përballlet me ndonjë kërcënim serioz dhe të drejtpërdrejtë nga vendet e Ballkanit Perëndimor përveç Serbisë, e cila ka pretendime territoriale. Në këtë punim do të shtjellojmë Sfidat e Sigurisë rajonale pas Luftës së Ftohtë, rasti i Kosovës.

Në këtë punim janë përdorë metodat përshkruese dhe kualitative apo cilësore. Në metodën përshkruese synojmë që të paraqesim sa më mirë që është e mundur faktet historike dhe kronologjinë e ngjarjeve në shpërbërjen e Jugosllavisë. Me metodën cilësore synojmë që të paraqesim rezultate konkrete duke u bazuar në burime primare dhe sekondare nga ekspertë apo publikime në fushën e sigurisë.

Integriteti territorial i Kosovës është politika më e mirë për paqen dhe sigurinë në Kosovë dhe në rajon. Ndarja apo shkëmbimet territoriale krijojnë precedent për ndryshime të kufijve në rajon, mund të destabilizojë rajonin duke provokuar ndryshime të mëtejshme të kufijve. Integrimi i Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Europian dhe në NATO është forma më efektive për të mbajtur stabilitetin dhe sigurinë në Ballkanin Perëndimor.

## **Metodologjia**

Në këtë punim janë përdorë metodat përshkruese dhe kualitative apo cilësore. Në metodën përshkruese synojmë që të paraqesim sa më mirë që është e mundur faktet historike dhe kronologjinë e ngjarjeve në shpërbërjen e Jugosllavisë. Me metodën cilësore synojmë që të paraqesim rezultate konkrete duke u bazuar në burime primare dhe sekondare nga ekspertë apo publikime në fushën e sigurisë.

## **Pyetja hulumtuese**

Cilat janë sfidat e sigurisë rajonale si rast i veçantë, Kosova?

## **Hipoteza**

Rritja e nacionalizmit serb shkaktoi shpërbërjen e Jugosllavisë me anë të luftërave të përgjakshme duke krijuar klimë të mosbesimit në mes të shteteve të Ballkanit Përqendror.

Integrimi i rajonit në organizatat Euro-Atlantike është rruga e duhur e shteteve të Ballkanit Përqendror në ballafaqimin ndaj sfidave të përbashkëta të sigurisë.

## **Përmbledhje**

Qëllimi i kësaj teme është që të paraqesim sfidat e sigurisë në rajon në fokus të veçantë në Kosovë. Ky punim përbëhet nga katër kapituj. Në këtë punim, në kapitullin e parë, do të përshkruhen ngjarjet historike dhe faktorët që kanë pasur impakt në shpërbërjen e Jugosllavisë si represioni i regjimit serb ndaj etnive tjera, luftërat në Kroaci, Bosnjë-Hercegovinë dhe në Kosovë.

Në kapitullin e dytë do të paraqiten ndërhyrjet ndërkombëtare në zgjidhjen e konflikteve në rajon. Gjithashtu, do të paraqiten misionet ndërkombëtare të instaluar me rezoluta të Kombeve të Bashkuara në ndalimin e konfliktit në ish-Jugosllavi. Pas luftimeve të shumta në Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë është mbajtur Konferenca e Dejtonit dhe vendimet e kësaj konference. Në këtë kapitull është e paraqitur dalja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në skenë dhe Konferenca e Rambujesë. Në përfundim të këtij kapitulli është paraqitur ndërhyrja e NATO-s në Kosovë.

Në kapitullin e tretë, jemi fokusuar në sfidat e sigurisë në vendet e rajonit apo Ballkanit Përqendror dhe integrimi i këtyre shteteve në NATO dhe BE. Ky kapitull trajton fenomenet negative që cenojnë klimën e besimit dhe bashkëpunimit rajonal. Gjithashtu, në këtë kapitull diskutohet për korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe luftimin e këtyre dukurive. Për më tepër, është diskutuar fuqizimi i shtetit ligjor dhe institucioneve demokratike në forcimin e paqes dhe të sigurisë dhe integrimin e shteteve të Ballkanit Përqendror në BE dhe NATO.

Dhe në kapitullin e katërt jemi fokusuar në Sfidat e Sigurisë në Kosovë. Brenda këtij kapitulli është diskutuar për ndërtimin e institucioneve të Sigurisë në Kosovë, Misionet ndërkombëtare me rezolutë të KB dhe shtrirja e autoritetit në Veri të Kosovës, Dialogu Kosovë-Serbi dhe gjetja e rrugës për zgjidhjen e problemeve. Në fund synimi i këtij punimi është të paraqesim rrugët e duhura për të arritur deri tek një e ardhme paqësore dhe të sigurtë në rajon. Rruga ideale për arritjen e një paqe dhe zhvillimi të qëndrueshëm si objektivë është integrimi i rajonit në Bashkimin Evropian dhe në NATO.